

VENDIM
Nr. 158, datë 20.10.2020

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “WENERG” SHA, PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT
TË ERE-s, PËR BARRËSIMIN E 100% TË AKSIONEVE TË SHOQËRISË NË FAVOR
TË BANKËS OTP**

Në mbështetje të nenit 16; të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 92, pika 1 dhe 2, të “Kodit të procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 20.10.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 109/7 prot., datë 14.10.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi kërkesën e shoqërisë “WENERG” sh.a. për marrjen e autorizimit të ERE-s, për barrësimin e 100% të aksioneve të shoqërisë,

konstatoi se:

- Shoqëria “WENERG” sh.a. është mbajtëse e licencës për prodhimin e energjisë elektrike nr. 104, seria PV10K, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 51, datë 5.7.2010, si dhe e licencës për tregtimin e energjisë elektrike nr. 184, seria T12P, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 137, datë 8.10.2012.

- Me shkresën nr. HD1-29/20 prot., datë 28.9.2020, shoqëria ka paraqitur kërkesën për të marrë autorizimin e ERE-s, për barrësimin e 100 % të aksioneve të shoqërisë për të garantuar kredinë nga kredidhënësi, Banka OTP ALBANIA sh.a. (ish Societe Generale Albania sh.a.), që përfaqëson një ristrukturim të kredisë me qëllim financimin e ndërtimit të Hec-it “Dardha 1”.

- Shkresa e shoqërisë është nënshkruar në emër të administratorit të shoqërisë “WENERG” sh.a. nga një person që, referuar ekstraktit të QKB-së, nuk rezulton të jetë administrator i shoqërisë, e po ashtu bashkëlidhur kësaj shkrese nuk rezulton të jetë depozituar autorizim apo prokurë përfaqësimi. ERE do t’i kërkojë informacion shoqërisë në vijim.

- Me anë të shkresave të saj, shoqëria ka njoftuar MIE-n për sa i përket nënshkrimit të marrëveshjeve me bankën, por nuk ka kërkuar miratimin paraprak të saj.

- Shoqëria ka deklaruar se “WENERG” sh.a. nuk ka hyrë në ndonjë marrëveshje të tillë për të cilën kërkohet miratimi paraprak i Autoritetit Kontraktues.

- Në zbatim të pikës 2.1, të marrëveshjes sigurorese, Banka (barrëmarrësi), në rast mospërmbushjeje, ka të drejtën për të ekzekutuar menjëherë të gjitha detyrimet e siguruara sipas kësaj marrëveshjeje e kësajsoj transferimin e aksioneve të shoqërisë.

- ERE vlerëson se pretendimi i shoqërisë “WENERG” sh.a., se nuk ka hyrë në ndonjë marrëveshje të tillë, për të cilën kërkohet miratimi paraprak i Autoritetit Kontraktues, është i pambështetur në kuadrin ligjor.

- Shoqëria nuk ka depozituar në ERE miratimin paraprak të Autoritetit Kontraktues, në zbatim të nenit 17, pika 1, germa “iii”, të kontratës së koncesionit, ku përcaktohet se çdo transferim tjetër nga koncesionari, ose filiali i tij, për një palë të tretë, të të paktën 51% të aksioneve në shoqërinë e re, do t’i nënshtrohet miratimit paraprak të Autoritetit Kontraktues. ERE do të kërkojë informacion në lidhje me zbatimin e këtij detyrimi kontraktor.

- Shoqëria ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj ERE-s, për sa i përket pagesave rregullatore.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Shtyrjen me 30 ditë të vendimmarrjes së ERE-s për dhënien e autorizimit për barrësimin e 100% të aksioneve të shoqërisë “WENERG” sh.a., në favor të Bankës OTP ALBANIA sh.a.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti